


Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **02.07.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-687/12, për z. *Rrahman Paçarizi* – Kryetar i Bordit të Radio Televizionit të Kosovës, për shkak se i njejtë, tashmë, nuk ushtron funksionin e personit të lartë zyrtar, dhe nuk ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë dyshimin e bazuar për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-687-12, për Zyrtarin e lartë, z. Rrahman Paçarizi – Kryetar i Bordit të Televizionit të Kosovës (RTK), është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas identifikimit të rastit (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), sipas të cilit është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në Kolegj Universitar privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të konfliktit të interesit konsiderohet papajtueshmëri funksionesh, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, z. Rrahman Paçarizi, është paraqitur në Agjencinë kundër Korrupsionit, dhe në takim me zyrtarët e Agjencisë ka njoftuar se funksioni i tij si

Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Radio Televizionit të Kosovës ka qenë me mandat dhe ai tashmë ka skaduar.

Për këtë, Zyrtari i lartë, Paçarizi, në Agjenci ka sjellë edhe një dokument zyrtar të lëshuar nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës, të quajtur “Përfundim”, (DPK/DPKI-03-1801/2012) në të cilin ndër tjera thuhet se: ” Me datën e skadimit të mandatit për kryetarët dhe anëtarët e organeve të pavaruara, pushojnë të gjitha të drejtat dhe obligimet e tyre....”

Në bazë të këtij dokumenti zyrtar, dhe deklarimeve të vet zyrtarit, se më nuk ushtron funksionin e të qenurit Kryetar i Bordit, kemi konstatuar se është shmangur situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) .

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtore Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Prteni

